

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar më:	20.01	20	20
Prilajeno:			
Njësia Jednica	Numri Proj	Shtojca Dodatak	
1-060	3655		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Nr. i protokollit	
Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i komunës
Nga :	Haqif Rrustemi, Koordinator i KKSB
Lënda:	Informatë për punën e KKSB për vitin 2019
Datë :	20. 01. 2020

I Nderuar kryetar.

Në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB, përkatësisht 03/2012 të MAPL jemi të obliguar që para kuvendit komunal të paraqesim Informatën e Kryesuesit për punën e KKSB për vitin e kaluar.

Duke përcjell punën e këtij këshilli në të gjitha takimet e mbajtura dhe rilexuar Procesverbalet e takimeve, - kam hartuar Informatën ashtu siç kërkohet me UA të cituar me lartë. Nëse mendoni se e njëjta është korrekte dhe shprehë punën e bërë gjatë këtij viti, luteni ta nënshkruani dhe procedoni tutje për shpërndarje kuvendarëve të KK Lipjan.

Me respekt.



Ë
REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të komunës / KKSB/

Nr _____

Datë : 12. 12. 2019

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Policinë (Ligji nr. 04/ L-076) , nenit 9 paragrafi 1.8. të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB, përkatësisht UA 03/2012 të MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kryetari i komunës së Lipjanit i propozon Kryesuesit të Kuvendit komunal të Lipjanit që të vendos në rend dite :

Informatë për punën e KKSB të Lipjanit gjatë vitit 2019

Kuvendi komunal i Lipjanit në mbledhjen e datës 22. 12. 2017 përveç tjerash ka themeluar edhe Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas rregullit kuvendit ka nxjerrë Vendimin për emërim të cilin ua ka dërguar të emëruarve, ministrive përkatëse dhe e ka publikuar në Web faqen zyrtare të komunës.

Përfaqësimi i komuniteteve etnike e fetare, institucioneve relevante të sigurisë, shoqërisë civile dhe grupeve me interesa të veçanta në KKSB e komunës sonë është bërë duke respektuar në tërësi udhëzimin administrativ të cituar më lartë.

Kryetari i komunës njëheri Kryesuesi i KKSB ka thirrur dhe ka mbajtur mbledhjet sipas procedurave të parapara me UA ku preferohet që brenda vitit kalendarik të mbahen 6 takime të rregullta dhe takimet tjera mund të mbahen për shkak të ndonjë rrethane të jashtëzakonshme ose shqetësimi apo kërcënimi të sigurisë në territorin e komunës apo të ndonjë komunitet i veçantë.

Këshilli gjatë vitit raportues ka thirrur 6 takime të rregullta prej të cilave një takim nuk është mbajtur për mungesë kuorumi e cila ishte shkaktuar për shkak të vonesës në dërgimin e ftesave anëtarëve. Gjatë vitit janë mbajtur edhe takime tjera të KKSB ku janë trajtuar tema tjera që kanë të bëjnë me ngritjen e performancës së KKSB ku nga ekspert të Qeverisë dhe UNDP është trajtuar çështja hartimit të planit vjetor të punës si dhe e raporteve vjetore. Një takim i tretë joformal i iniciuar jashtë KKSB është mbajtur për të diskutuar disa prej kërcënimeve të cilat po shfaqen tash kohëve të fundit në vendin tonë.

Marrë së bashku KKSB gjatë vitit 2019 ka mbajtur 8 takime duke realizuar shumicën e aktiviteteve të parapara me Planin Vjetor të Veprimit. Aktivitetet të cilat nuk kanë gjetur zbatim gjatë vitit janë ato të cilat kanë pasur kosto financiare.

I nderuara kryesues, të nderuar anëtar të Kuvendit komunal, në përputhje me nenin 9. Paragrafi 1. pika 7. e UA të cituar më lartë kryetari i Komunës - Kryesuesi i KKSB , - pas propozimit të planit kornizë nga koordinatori i këshillit dhe diskutimeve në forum, me pak vonesë pati aprovuar Planin e veprimit për vitin 2019. Kjo është shkaktuar për dy arsye kryesore. E para se disa dokumente bazë nuk kishin arritur nga niveli qendror dhe e dyta se

anëtarët e KKSB,- përfaqësues të komuniteteve etnike e fetare, të institucioneve të përfaqësuara, e shoqëria civile nuk kishte bërë propozime të shkruara se cilat nga brengat dhe shqetësimet e tyre duan fillimisht ti prezantojnë, diskutojnë dhe arsyetojnë para se ato të futen në plan të veprimit.

Në anëtarët e KKSB në vazhdimësi kemi punuar sipas aktiviteteve dhe detyrave të përcaktuara me këtë plan por në raste të veçanta edhe sipas kërkesave të komunitetit përkatësisht situatës në terren.

Në planin vjetor të punës së KKSB rregullisht planifikohen tre lloje aktiviteteve:

- Detyrat e rregullta programore të caktuara me udhëzim administrativ e që përmbushin misionin e KKSB-ve,
- Shqetësimet specifike të komuniteteve të komunës sonë të cilat janë prezentë dhe të cilat kërkojnë zgjidhje dhe
- Shqetësimet akute të cilat nuk janë të parashikueshme e të cilat megjithatë kërkojnë aktivitet të KKSB dhe të institucioneve profesionale të sigurisë.

Nga përcjellja e rregullt e punës së KKSB por edhe nga rishikimi i procesverbaleve të takimeve mund të vërehen edhe mangësitë në funksionimin e tij. Po përmendim vetëm disa:

- Anëtarët e njëjtë aktiv në secilin takim dhe të tjerë prapë të njëjtë që nuk diskutojnë gati asnjëherë,
- Mungesa e vizionit dhe ideve të reja për ti propozuar në Planin Vjetor të Punës
- Mungesa e interesimit për hartimin e PVP dhe Raportit Vjetor ,në vend se të ishte punë kolektive kjo bëhet nga një individ,
- Interesimi i pamjaftueshëm për të këmbyer më shume informacion lidhur me çështjet e ngritura në takimet paraprake.
- Koordinim i pamjaftueshëm rreth inicimit dhe zbatimit në terren të fushatave të përbashkëta vetëdijësuese.
- Mungesa e takimeve të përbashkëta me KKSB e komunave fqinje apo takimeve në nivel regional etj.

Në takimet e rregullta përveç anëtarëve gati rregullisht marrin pjesë përfaqësuesit e OSCE, Ekipi LMT i KFOR-it, ICITAP . Mbledhjet janë të hapura për publikun, ftesat përveç se individualisht për anëtarët e KKSB botohen edhe në Web faqen e komunës.

Nga aktivitetet e planifikuara me planin vjetor zakonisht po realizohen vetëm aktivitetet apo detyrat rutinore dhe nuk janë realizuar aktivitet të cilat kanë pasur një kosto të implementimit . Aktivitete të parapara me Planin Vjetor të veprimit si vetëdijësimi i popullatës për zjarret në përgjithësi dhe ato malore në veçanti , projekti për trajtimin e qenve endacak as sivjet sikurse edhe tre vitet e fundit me radhë nuk janë realizuar. Mosrealizimi i tyre lidhet direkt me mungesë vullneti nga planifikuesit e buxhetit në nivel komunal. Buxheti komunal për vitin pasues përgatitet dhe aprovohet zakonisht në korrik – gusht për vitin e ardhshëm dhe për këtë ne nuk njoftohemi asnjëherë ndërsa Plani Vjetor përfshirë edhe planifikimin e buxhetit për punën dhe projektet e KKSB hartohet në fillim të janarit.

Plani vjetor i KKSB para se të vije për aprovim në KK zakonisht kalon edhe nëpër Komitetin përkatës për Politikë dhe Financa ku diskutohet edhe kostoja financiare . Asnjëherë nuk ka pasur kërkesë nga KPF e as nga Ju të nderuar kuvendar që të anulohet ndonjë projekt i KKSB apo të reduktohet për shkak të koston financiare megjithatë

projektet që kanë pasur kosto nuk janë realizuar. Edhe ashtu së bashku projektet tona kurrë nuk kanë kaluar shumën katër shifrore.

Për zvogëlimin e kërcënimit nga disa rreziqe si qentë endacak ne ende jemi në kërkim të një rrugë zgjidhjeje regjionale dhe afatgjate me komunat fqinje dhe kemi arritur një pëlqim me komunën e Prishtinës dhe të Shtimes në këtë drejtim dhe po punojmë që këtij aktiviteti ti bashkëngjiten edhe komunat tjera fqinje. Përkundër kësaj ka fare pak shpresë se do të gjendet një zgjidhje e pranueshme dhe me kosto të përballueshme për shkak të legjislacionit evropian të kësaj fushe.

Gjatë vitit nga anëtarët e KKSBB janë ngritur dhe trajtuar edhe shqetësime tjera si ;

- Pastrimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve dhe proçkave,
- Dyshimet e rritura për përdorimin dhe shpërndarjen e substancave narkotike në lokale të ndryshme dhe në shkolla,
- Instalimi i kamerave në shkolla, kryqëzime rrugësh dhe pranë vendeve dhe institucioneve më të frekuentuara,
- Ndryshimi publik në disa lagje periferike të Lipjanit, dhe në fshatra,
- Rritja e rasteve të dhunës në familje e në veçanti ndaj grave,
- Përshkallëzimi ekstrem i rasteve nga vjedhjet e rëndomta drejt hyrjes në pronë dhe grabitjes me armë zjarri
- Siguria në rrugë e shqetësime tjera më të vogla ose me karakter lokal.

Shqetësime të identifikuar nga anëtarët e EVSB dhe anëtarët e KKSBB të cilat janë shndërruar në aktivitete të realizuara mirë që rrisin nivelin e sigurisë së qytetarëve të komunës sonë janë:

- pastrimi i shtretërve të lumenjve nga bimësia dhe materialeve inerte në to,
- Rregullimi me material solid i segmenteve të shtretërve të cilët kalojnë nëpër disa vendbanime,
- Rregullimi i shumë hapësirave publike të cilat ishin shndërruar në deponi hedhurinash të cilat tani janë gjelbëruar dhe po pajisen edhe me ulëse e aksesori tjerë për lojëra e tj.

Ne jemi të vetëdijshëm se misioni i KKSBB nuk ka përfunduar me kaç. Sigurisht se disa nga çështjet dhe sfidat e trajtuara për çdo vit kanë për të qenë aktuale edhe për kohë tjera, në ndërkohë do të lindin edhe kërcënime tjera të cilat kërkojnë zgjidhje.

Me respekt.

